



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 118

Prishtinë, më 25.9.2024, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Adnan Rrustemi, Driton Selmanaj, Artan Abrashi, Dimal Basha, Arijeta Rexhepi, Erxhan Galushi, Hydajet Hyseni- Kaloshi dhe Besnik Tahiri.

Munguan: Blerta Deliu-Kodra dhe Hajdar Beqa.

Mbledhjen e kryesoi Adnan Rrustemi, kryetar i Komisionit.

Pjesëmarrës të tjerë: Albulena Haxhiu, ministre e Drejtësisë, Genc Nimani dhe Agnesa Hasani, MD; Lulzim Kelmendi, praktikant; Blerina Istrefi, GLPS; Argjend Zhupi, EUSR; Fjollë Haziri, KDI; Naim Jakaj, IKD; Detrina Alishani, KK; dhe Valjeta Shala, RTK.

Stafi mbështetës i Komisionit: Fatbardha Boletini dhe Mirlinda Kolgeci.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-322 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme;
3. Raport me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-276 për ndyshimin dhe plotësimin e ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat;
4. Raport me amendamente për Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L- 087 për kundërvajtje;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me propozimin e kryetarit, ku pika e dytë e rendit të ditës, të zhvendoset në pikën e tretë të rendit të ditës, dhe pika e tretë, të zhvendoset si pikë e dytë.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.08/L-322 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme

Kryetari paraqiti për shqyrtim në parim raportin Projektligjin nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme dhe ftoi ministren e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu, për të prezantuar ndryshimet e projektligjit, pas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Albulena Haxhiu, prezantoi Projektligjin nr. 08/L-322 për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, që njëherësh paraqet edhe një nga projektligjet më të rëndësishme në kuadër të përpjekjes për të luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe për të ndjekur pasurinë e pajustificueshme.

Siç e dini, më 29 korrik të këtij viti, Gjykata Kushtetuese ka shpallur aktgjykimin, në raport me këtë ligj dhe pas këtij aktgjykimi, Ministria e Drejtësisë me përkushtim ka adresuar gjetjet e Gjykatës. Është ndjekur edhe linja të cilën e ka adresuar Gjykata Kushtetuese, përmes këtij aktgjykimi. Ndërkaq, njoftoi se për Ministrinë e Drejtësisë, për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, është jashtëzakonisht e rëndësishme që Gjykata Kushtetuese nuk e ka kontestuar në asnjë formë konceptin e konfiskimit civil. Pra, kjo është tejet e rëndësishme, andaj beson që nuk ka pasur nevojë që të bëhet ndonjë ndryshim në këtë drejtim. Konfiskimi civil edhe sipas Gjykatës Kushtetuese është vlerësuar si instrument legjitim dhe proporcional për luftën kundër korrupsionit në sektorin publik dhe beson që është një arritje e madhe e shtetit të së drejtës. Për të sqaruar, ministrja tha se nuk kemi adresuar një ligj të ri, pra nuk kemi draftuar nga fillimi ligjin përkatës, por kemi adresuar vetëm katër nene, gjegjësisht çështjet që i ka ngritur Gjykata Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese nuk ka thënë se i gjithë projektligji është në kundërshtim me Kushtetutën, por e ka shpallur të pavlefshëm, për shkak të katër neneve të tij.

Së pari, është çështja e retroaktivitetit. Kjo ka qenë çështje mjaft e ndjeshme, shumë debat për të njëjtën. Gjykata Kushtetuese nuk e ka refuzuar parimisht retroaktivitetin, por ka theksuar se duhet të zbatohet me kujdes dhe duke respektuar parimin e proporcionalitetit. Në këtë drejtim, është përfshirë koncepti i pamundësisë objektive, i normuar përmes nenit 35 të këtij projektligji. Ky koncept është interpretuar për të adresuar sfidat që mund të hasen nga palët në sigurimin e provave, veçanërisht në situata kur kalimi i kohës ose faktorë të tjerë objektivë e bëjnë të pamundur sigurimin e provave të kërkuara. Konkretisht, në rastet kur pala ka ditur për pasuri të pajustificueshme, pra nuk është në gjendje që të sigurojë provat e nevojshme për të justifikuar prejardhjen e pasurisë së saj, ajo ka të drejtë të paraqesë dëshmi që tregon pamundësinë objektive për të siguruar ato prova. Në këto rrethana, pala duhet të ketë mundësinë të sqarojë se provat janë

jashtë kontrollit të saj, që ndërlidhen me kalimin e një periudhe të gjatë kohore rreth cilësisë së ruajtjes së dokumentit ose faktorëve tjerë të jashtëm, që e kanë pamundësuar këtë proces. Pra, Gjykata, duke marrë parasysh këtë dëshmi të pamundësisë objektive, do të vlerësojë nëse ekzistojnë rrethana të mjaftueshme për të konsideruar se mungesa e provave nuk është rezultat i fajit të palës, por pasojë e rrethanave të jashtme. Si rezultat, edhe kur Gjykata gjen se këto rrethana objektive ekzistojnë dhe kanë penguar palën të sigurojë provat e nevojshme, ajo mund të refuzojë propozimin për konfiskimin, si të pabazuar, për atë pjesë të pasurisë, jo të gjithë pasurisë që verifikohet. Ky koncept i pamundësisë objektive, sugjerohet edhe nga vetë Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, bazohet edhe në opinionet e Venecias që i ka përmendur vetë Gjykata Kushtetuese që ndërlidhen me Malin e Zi, por edhe me Bullgarinë, ku kanë hasur sfida të ngjashme për zbatimin e ligjeve për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. Kjo synon që të sigurojë një procedurë më të drejtë dhe më të balancuar, duke marrë parasysh rrethanat specifike të secilit rast dhe duke ofruar mbrojtje shtesë për individët që përballen me vështirësi të papritura në justifikimin e pasurisë së tyre.

Gjatë kohës sa Ministria ka qenë duke punuar në këtë çështje, kanë mbledhur të gjitha institucionet të cilat merren me të dhënat e zyrtarëve, që ndërlidhen me Noterinë, me çështjen e Njësitit të Inteligjencës Financiare, BQK-në, institucionet tjera, si Dogana, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Kanë pasur takime me Departamentin e Tatimit në Pronë, ATK-në dhe i kanë pyetur se sa kohë i ruani të dhënat, për shkak se disa ligje parashohin dhjetë vite disa ligje pesë vite. Ata na kanë njoftuar se të gjitha të dhënat, prej momentit kur këto institucione ekzistojnë, janë tashmë të ruajtura dhe asgjë nuk kanë shkatërruar. Nëse ju interesojnë të njëjtat përgjigje, i kanë kërkuar edhe me shkrim, prandaj mund t'i ofrojnë për anëtarët e Komisionit, përgjigjet e tyre. Megjithatë, kanë qenë të detyruar ta adresojnë pamundësinë objektive në nenin 35 të këtij projektligji.

Çështja e dytë, që konsideron se është po aq e rëndësishme, është qartësia e periudhave kohore për verifikimin e pasurisë. Një pikë tjetër e ngritur nga Gjykata Kushtetuese ishte nevoja për qartësim në lidhje me periudhat kohore brenda, të cilave Byroja mund të verifikojë pasurinë e fituar. Sipas ndryshimeve të reja, periudha e verifikimit do të lidhet ekskluzivisht me periudhën kur zyrtari publik ka qenë në funksion, përjashtimisht verifikimi mund të zgjatet deri në pesë vite, pas përfundimit të detyrës publike, nëse ka prova të dukshme që pasuria është më e madhe sesa të ardhurat e ligjshme. Këto ndryshime janë adresuar përmes neneve 2, 9, 10 dhe 23 të këtij projektligji. Për të sqaruar përfundimisht, ky ligj zbatohet ndaj pasurisë së pajustificuar të fituar nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit dhe atë nga shpallja e pavarësisë, 17 Shkurt 2008, dhe pas përfundimit të ushtrimit të funksionit të tij përfshirë periudhën deri në 5 vite, prej kur zyrtari publik ndalon së ushtruari funksionin.

Çështja tjetër është Komisioni Mbikëqyrës dhe ndarja e pushteteve. Gjykata Kushtetuese ka kërkuar ndryshimin e përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës për të garantuar respektimin e parimit të ndarjes së pushteteve, andaj në versionin e ri të projektligjit, Komisioni do të përbëhet nga pesë anëtarë, tre do të zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, sipas procedurave që i gjeni në projektligj. Po ashtu, në këtë Komision do të jetë dhe drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe drejtori i Njësitit të Inteligjencës Financiare. Për këtë qëllim, kemi ndryshuar nenin 10 që rregullon përbërjen e Komisionit Mbikëqyrës dhe kemi ndryshuar me një nen të ri, që është neni 11, që rregullon mënyrën e zgjedhjes së tre anëtarëve të Komisionit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Këto ndryshime janë të rëndësishme për të garantuar që proceset e zgjedhjes të jenë transparente dhe në përputhje me standardet e ndarjes së pushteteve. Gjithnjë duke u bazuar në një proces të drejtë, por po ashtu dhe në një proces të pavarur.

Projektligji për Byronë Shtetërore për verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, siç e keni parë në tërësi, përmban 72 nene të strukturuar në 14 kapituj. Megjithatë, duke marrë parasysh se përmbajtja e këtij projektligji është pothuajse identike me atë që është proceduar më herët, që Kuvendi e ka votuar, nuk kemi hartuar një projektligj të ri, por i kemi adresuar vetëm çështjet të cilat Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar që nuk janë në linjë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Prandaj, është tejet e rëndësishme që të fokusojmë diskutimin në këto, pa dashur të ndërhyj në mandatin dhe në përgjegjësitë që keni. Të fokusohemi në këto çështje, sepse tashmë çështjet tjera, si: koncepti i konfiskimit civil, a duhet të vlejë ky ligj për gjithë qytetarët e apo vetëm zyrtarët, janë sqaruar nga Gjykata Kushtetuese, janë validuar nga Gjykata Kushtetuese. Prandaj, fokusi duhet të vendoset në këto çështje, por është e hapur natyrisht dhe për çështje tjera që i konsideroni me interes. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky projektligj, ju ftoj që ta votoni dhe tani besoj që nuk ka më qoftë as edhe ndonjë arsye teknike për ta kontestuar Gjykata Kushtetuese.

Kryetari, tha se angazhimi i Qeverisë nuk ka qenë në draftimin nga fillimi të këtij projektligji, por përqendrimi te katër gjetjet e Gjykatës Kushtetuese, për të adresuar vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese për mospërputhshmërinë e këtyre katër elementeve me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Besnik Tahiri, tha se kanë qenë katër probleme serioze. E para lidhet me fushëveprimin, e dyta që ka qenë shumë problem dhe vazhdon të jetë dhe ka nevojë për disa sqarime me përbërjen e Komisionit dhe kompensimin, për shkak se ne po flasim për t'i zgjedhur tre në Kuvend, por pastaj 'ex officio' dy: drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe po ashtu drejtorin e Njësitit për Inteligjencën Financiare. Pyetja e parë e tij është se si e keni menduar pavarësinë e këtij institucioni shumë të rëndësishëm, kur 'ex officio' i kemi dy dhe tre vijë nga Kuvendi. Në esencë, po flasim për katër persona të Kuvendit, për shkak se drejtori i ardhshëm këtij institucioni, i Agjencisë Kundër Korrupsionit, zgjidhet nga Kuvendi dhe janë tre të tjerë të cilët i zgjedh Kuvendi. Pra, këtu ka problem me pavarësinë institucionale të trajtimit të një teme të rëndësishme. Periudha e verifikimit të pasurisë është në rregull.

Neni i kontestuar ka qenë neni 34. Neni 34 e ka trajtuar temën e shkallës së parë. Tani, çfarë ka ndryshuar këtu pak më saktë, është me rëndësi, ku është arsyetimi? Ajo që mund ta thotë si dikush që mbështet qëllimin e këtij ligji, se qëllimi i ligjit është legjitim, është pasuria e fituar në mënyrë të pajustificueshme të trajtohet prej një institucioni, edhe pse është trajtuar përpara prej gjykatave, mirëpo një institucioni që ju e keni si program, që ka qenë edhe në programin tuaj politik. Problemi është ky: përbërja e Komisionit, për vlerësimin e tij i nënshtrohet jo një vetingu publik, por një votimi dhe legjitimimi që do të vijë nga Kuvendi, tre të cilët do të zgjidhen me shumicë në Parlament dhe një i cili që veçse është zgjedhur, e ka një detyrë publike, por është i votuar nga shumica. Pra, në këtë kontekst, ndikimi politik i një institucioni, në këtë institucion që nuk duhet të jetë, sepse ky institucion një punë nuk duhet ta bëjë: nuk duhet të bëjë përndjekje politike, duhet të bëjë përndjekje si është qëllimi i ligjit, legjitime të adresimit të pasurisë që nuk mund të justifikohet. Secili duhet të tregojë nga e ka pasurinë, mirëpo jo të jetë një gjuajtje politike. Dhe nëse ka mundësi te përbërja, si e keni menduar pavarësinë e elementit që e ngriti? Dhe e dyta, lidhet te procedura e shkallës së parë, i cili ka qenë ndryshimi thelbësor te neni 34.

Albulena Haxhiu, sqaroi se Komisioni për të cilin po pyesni dhe po i referoheni, ka për mandat

që të mbikëqyrë mënyrën se si do të funksionojë Byroja në të ardhmen. Pra, ndërlidhet me ushtrimin e veprimtarisë së mbikëqyrjes së Byrosë. Në projektligjin e kaluar, kemi pasur një përbërje tjetër, ku kjo na është hedhur poshtë nga Gjykata Kushtetuese, pikërisht për shkak se Gjykata Kushtetuese ka konsideruar se nuk është në linjë me Kushtetutën, për shkak se ne kemi paraparë që në këtë Komision të jetë auditori i Përgjithshëm. Po ashtu, kemi paraparë që në këtë Komision të jetë një gjyqtar i Gjykatës Supreme, i caktuar nga kryetari i Gjykatës Supreme. Dhe po ashtu, një zëvendës i caktuar nga Avokati i Popullit. Por, Gjykata Kushtetuese, të tria këto pozicione i ka konsideruar në kundërshtim me Kushtetutën. Ndonëse, nëse i referohemi opinionit të Venecias, flet ndryshe. Pra, Komisioni i Venecias, gjithnjë, edhe kur është folur për Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës, edhe për Ligjin për Byronë, ka zgjeruar përfshirjen e institucioneve në këto mekanizma, por që Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se kjo nuk është në linjë me Kushtetutën. Duke pasur për bazë këtë, ne nuk kemi pasur zgjidhje më të mirë sesa kjo që kemi propozuar dhe kemi adresuar që në këtë përbërje të jenë pesë anëtarë, me tre anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, pastaj drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe drejtori i Njesisë të Inteligjencës Financiare, me një mandat 5- vjeçar, por pa të drejtë rizgjedhjeje. Ne vlerësojmë që nuk kemi mundësi të tjera kushtetuese, por edhe ligjore që ta adresojmë ndonjë votim ndryshe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sepse e dimë si kalojnë ligjet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por edhe aktet tjera në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pra me një votim të thjeshtë në Kuvend. Prandaj, vlerësoj që nuk ndërlidhet me ndonjë ndikim në të ardhmen, përkundrazi janë kujdesur që t'i përforcojnë kriteret ligjore se kush duhet të jetë në këtë Komision. Dhe siç e dini, përveç që duhet të jetë shtetas i Republikës së Kosovës, të ketë përgatitje universitare nga fusha e drejtësisë, ekonomisë, administratës publike. Pesë vite përvojë profesionale në çështjet ligjore, të drejtat e njeriut, ekonomisë dhe administratës publike. Por, çfarë është e rëndësishme, është të mos jetë anëtar ose të ushtrojë funksion në cilindo subjekt politik, shoqatë apo fondacion të lidhur me ndonjë subjekt politik, ose të mos jetë zgjedhur drejtpërdrejt nga zgjedhjet ose të mos jetë anëtar i Qeverisë, ose i emëruar politik, në pesë vitet e fundit dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale.

Megjithatë, nëse Komisioni për Legjislacion vlerëson se duhet një autoritet tjetër të jetë i përfshirë në këtë, tha se janë të hapur që ta diskutojmë se kush është ai autoritet tjetër, por për Ministrinë e Drejtësisë ka qenë shumë e vështirë të gjendet një institucion që ka pak a shumë përgjegjësi të përafërt me këto që do t'i ketë Byroja, që ndërlidhen me çështjet financiare dhe të tjera. Ju e dini që edhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit edhe Njësi i Inteligjencës Financiare, merren me këtë. Prandaj, i kanë vlerësuar si dy institucione kompetente, dhe në anën tjetër, i përket Kuvendit të Republikës së Kosovës që të zgjedhë anëtarët, të cilët kanë integritet dhe që nuk ndikohen në të ardhmen. Drejtori i këtij institucioni, kur të zgjidhet, do t'i raportojë Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ju do ta keni përgjegjësinë po ashtu në këtë drejtim. Ky Komision do të jetë vetëm mbikëqyrës në mënyrën sesi do të funksionojë Byroja, në të ardhmen.

Në anën tjetër, sa i përket çështjes në nenin 34, ndonëse ka pasur lëvizje, është 35. Një nga çështjet që Gjykata Kushtetuese e ka kontestuar, ka qenë pikërisht kjo. Gjykata Kushtetuese ka thënë se është cenim i sigurisë juridike, nëse pala kërkon që të marrë një dokument, por që nuk e gjen atë, sepse ka kaluar periudhë e gjatë. Gjykata Kushtetuese ka marrë dy shembuj të dy shteteve: Bullgarinë dhe Malin e Zi, të pamundësia objektive. Pra, nëse personi (pala) shkon në një bankë që të marrë një transaksion që e ka realizuar para shumë viteve, gjegjësisht pas vitit 2008, nëse këtë nuk mund ta sigurojë, atëherë duhet ta bëjë të ditur për institucionin këtë dhe pastaj Gjykata nëse e vlerëson që ekzistojnë rrethanat objektive që pala nuk mund të sigurojë këtë, atëherë pushon procedura për atë pjesë të pasurisë. Ka qenë e vetmja zgjidhje që të sigurohemi se nuk po e cenojmë

sigurinë juridike dhe jemi në linjë me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese.

Besnik Tahiri, tha se te çështja e Komisionit ka një problem serioz. Problemi është që katër anëtarët në esencë, janë persona të zgjedhur nga Kuvendi dhe i pesti është nga Qeveria. Këtu është elementi i pavarësisë. Pra, kur po flet për këtë temë, e ka ngritur edhe në instanca tjera. Ky institucion është legjitim dhe qëllimin e ka legjitim, trajtimin e pasurisë së pajustificueshme deri në konfiskim. Komisioni, i cili e mbikëqyr dhe në fakt në teorinë e palës kryesore është instanca e cila kërkon llogari dhe përgjegjësi prej këtij institucioni, burimin e ka te një shumicë parlamentare, në të ardhmen. Dhe këtu është problemi me pavarësinë, për shkak se tre janë të zgjedhur, një është zgjedhur më herët nga shumica me një procedurë të votimit dhe pastaj në instancën e vendosur prej Qeverisë. Këtu qëndron problemi me pavarësi dhe ajo që quhet “checks and balance”, mekanizmi i kontrollit dhe balancit në një institucion që do të trajtojë tema serioze.

Driton Selmanaj, tha se që nga fillimi i idesë kur është paraqitur inkorporimi në sistemin tonë, konfiskimi civil, si institut i ri, nuk kemi pasur ide kundër. Nuk kemi qenë kundër qëllimit, nuk kemi qenë kundër idesë që vërtet Kosova të gjejë mënyra sesi të trajtojë konfiskimin e pabazë. Por, i gjithë investimi jonë ka qenë sesi po e bëjmë këtë. Pra, a po e bëjmë në mënyrën më të mirë të mundshme apo po e prishim sistemin dhe më pas në çfarë labirinte mund të futemi dhe ku do dalim? Ka pasur një procedurë, ka shkuar në Komisionin e Venecias, keni insistuar se janë marrë parasysh rekomandimet e Komisionit të Venecias. Ne kemi thënë se nuk janë marrë parasysh dhe Gjykata Kushtetuese në fund e vërtetoi që nuk janë marrë parasysh. Po e sheh tani iniciativën e re tuajën dhe ka provuar me kujdes ta analizojë në detaje. Po ashtu, tha se po e sheh si punë për qëllime elektorale në fund të mandatit tuaj dhe nuk po e sheh që vërtet qëllimi është të nxirret një ligj, i cili do të jetësohet në praktikë. Sepse përsëri ideja e pavarësisë së këtij institucioni nuk është e adresuar. Komisioni Mbikëqyrës, të cilit ju i keni dhënë mandat që të nxjerrë edhe rregulloren e organizimit të brendshëm, i gjithë institucioni është tërësisht i varur nga shumica politike në Kosovë. Ne jemi në fund të mandatit dhe nuk e dimë çfarë qeverie do të vijë, a do të jeni ju, a do të jetë dikush tjetër, apo çfarë shumice do të jetë. Pra, problematikë është varësia te shumica e thjeshtë politike në Kuvend të Kosovës. Në përbërje ju keni menduar që tre anëtarë të zgjidhen nga Kuvendi, me shumicë të thjeshtë, me 30 vota. Edhe drejtori i Agjencisë që zgjidhet po ashtu me 30 vota dhe shefi i Njësisë së Inteligjencës Financiare që zgjidhet nga Qeveria, e që Qeveria është pjesë e shumicës politike në vend. Ky institucion i subordinuar partisë politike në pushtet, kushdo qoftë ajo nesër. Prandaj, pavarësia nuk është adresuar fare në këtë projektligj.

Çështja tjetër, që e ka analizuar me kujdes dhe nuk po arrin te shpjegimi, është neni 16, paragrafi 16, zgjedhja e drejtorit. Ky paragraf flet për rastet kur dështon zgjedhja e drejtorit me procedura të rregullta në Kuvend: “Në rast se edhe pas përsëritjes së konkursit, Kuvendi dështon në zgjedhjen e drejtorit të Përgjithshëm në dy raunde, atëherë Komisioni, shpall konkursin dhe zhvillon procedurat sipas këtij neni, me përjashtimin e vetëm se Komisioni në fund të procesit zgjedh kandidatin me më së shumti pikë si drejtor të Përgjithshëm.” Pra, nëse do të mund të jepni shpjegime. Nëse përsëriten procedurat dhe 10 herë apo 20 herë procedurat do të jenë të njëjta. Shumica e thjeshtë është problematike. Dikush provon që të thotë se është çështje kushtetuese, mendon se në situatat e caktuara duhet ta kemi parasysh. Edhe në kontekst të cenimit të lirive dhe të drejtave të njeriut, kjo çështje është sërish vlerësim subjektiv dhe ka bindjet që nuk është adresuar sa duhet dhe si duhet, sikur që ka pasur bindjen dhe në të kaluarën që rekomandimet e Komisionit të Venecias nuk janë adresuar dhe ju keni insistuar se janë adresuar bashkë me

kryetarin e Komisionit. Si përfundim, tha se është mirë që të përfundojë edhe një herë në Komisionin e Venecias. Komisioni i Venecias të japë një vlerësim edhe një herë, për të parë rekomandimet e tyre a janë inkorporuar, sepse ata thonë jo, ju thoni po, dhe më pas, Gjykata Kushtetuese thotë jo. Në mënyrë që ne të kemi një dokument, i cili me të vërtetë do të jetësohet nesër, i cili me të vërtetë do të kryejë punën, nëse eventualisht do të kryejë punën, atëherë ne duhet të jemi të qartë që jemi duke ndërtuar një sistem që është komplet në frymën tonë kushtetuese, rendin tonë kushtetues dhe në përputhje të plotë me standarde ndërkombëtare. Parimisht, është që instituti i konfiskimit civil të fillojë të aplikohet dhe të zbatohet, por mënyra sesi e kanë zgjedhur nuk është përshtatur, me qëllimin fisnik që ekziston.

Albulena Haxhiu, tha se së pari deklarimet që ky projektligj po procedohet sërish, për arsye elektorale, nuk qëndron aspak për faktin se ka diku dhjetë vite përjekje të Vetëvendosjes edhe në kohën kur kanë qenë opozitë, që e kanë proceduar këtë projektligj në Kuvend, konceptin e konfiskimit civil. Pra, mund t'i shihni lirisht edhe informacionet për këtë, ka diku dhjetë vite ku si grup parlamentar, sa kanë qenë në opozitë, dy herë radhazi e kanë proceduar në Kuvend, por në atë kohë nuk e kishin shumicën dhe dështonte miratimi i tij. E po ashtu, nuk qëndron për faktin se e kanë pasur në programin qeverisës, si zotim dhe është e natyrshme, normale dhe e domosdoshme, që subjektet politike që zotohen para qytetarëve, që të merren me politikën e caktuara, në këtë rast me konfiskimin civil, gjegjësisht projektligjin në fjalë, të punojnë në përputhje me zotimet zgjedhore. Këtë nuk e kemi shpikur në fund të mandatit si ide, por diku që dhjetë vite, e sidomos në zgjedhjet e vitit 2021. Prandaj, çfarëdo deklarimi që po bëhet për arsyeje elektorale nuk qëndron, madje nuk i beson askush dhe sigurisht arsyeja e fundit është që e kemi proceduar këtë para 18-19 muajve. Kuvendi i Republikës, siç e dini, e ka votuar në lexim të dytë, por pastaj 17 muaj është dashur që ta presim Gjykatën Kushtetuese, në mënyrë që të nisim edhe një herë ndryshimin për çështjet, të cilat Gjykata Kushtetuese i ka konsideruar si kundërkushtetuese. Nuk kemi mundur më herët, për faktin se ka mbetur shumë gjatë në trajtim nga Gjykata Kushtetuese.

Sa i përket përbërjes së Komisionit Mbikëqyrës, tha se kanë pasur diskutime me anëtarët të cilët kanë qenë të fokusuar këtu dhe që janë në Ministrinë e Drejtësisë, Zyrën e Kryeministrit, ekspertët, pra një grup i ngushtë. Duke pasur parasysh që Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se institucionet apo autoritetet që i përmenda më herët, nuk janë në linjë me Kushtetutën, nëse janë në Komisionin Mbikëqyrës, atëherë nuk kanë pasur institucione tjera dhe nuk kanë pasur mundësi tjetër që ta rregullojnë. Mendon që e kanë bërë mirë si rregullim, por po ashtu i fton që nëse mendoni që ka një rregullim tjetër që duhet të bëhet, që nuk bie ndesh me Kushtetutën, gjithnjë, duke pasur parasysh atë çfarë Gjykata Kushtetuese ka thënë, janë të hapur që ta dëgjojnë, por jo që të përfshijmë në këtë Komision, institucione të cilat për Gjykatën Kushtetuese kanë qenë në kundërshtim me Kushtetutën. Mos të harrojmë që për këtë projektligj kemi tri opinione të Komisionit të Venecias, kemi një Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese, si Qeveri nuk kemi konsideruar që duhet ta riprocedojmë në Komisionin e Venecias, sepse nuk ka arsye më për këtë, të gjitha tashmë janë të qarta. Kuvendi i Republikës e ka tashmë në trajtim këtë projektligj. Nuk është e nevojshme, por fjala tani i përket Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sa i përket çështjes tjetër, Gjykata Kushtetuese e ka trajtuar këtë. Pra, për zgjedhjen e drejtorit nga Kuvendi dhe mekanizmin deblokues, Gjykata nuk konstaton cenim të parimit të sundimit të ligjit, parimin e sigurisë juridike, siç ka pretenduar parashtruesi në këtë rast, PDK që e ka kontestuar në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata po ashtu nuk ka konsideruar që ka shkelje në tërësinë e nenit të cilit e përmendët, përfshirë edhe paragrafin 16. Në këtë pikë, Gjykata ka ngritur dy çështje të cilat i kemi adresuar: zgjedhjen e drejtorit të Përgjithshëm nga Kuvendi, vetëm me shumicë të thjeshtë dhe mekanizmin deblokues të kalimit të kësaj kompetence në Komisionin Mbikëqyrës, në rast të

dështimit. Sa i përket zgjedhjes së drejtorit, Gjykata rikujton se zgjedhja e drejtorit të Përgjithshëm me shumicën e votave të gjithë deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Edhe në nenin 65, që ndërlidhet me kompetencat e Kuvendit edhe me nenin 80, të miratimi i ligjeve, përcaktohet një rregullim i tillë. Prandaj, edhe sa i përket mekanizmit deblokues, Aktgjykimi sqaron që mënyra e zgjedhjes së titullarëve, anëtarëve të agjencive të pavarura nuk është e saktësuar në dispozitat kushtetuese dhe për pasojë përcaktimi i mënyrës së zgjedhjes së drejtorit të Përgjithshëm të Byrosë, bazuar në paragrafin 1 të nenit 142, që ndërlidhet me agjencitë e pavarura, është në kompetencë të Kuvendit. Pra, e ka vlerësuar që është në kuadër të kompetencës së Kuvendit, për ta vlerësuar nëse duhet të ketë një mekanizëm deblokues. Duke pasur parasysh se Gjykata Kushtetuese, tashmë është marrë me këto nene, sepse janë kontestuar nga PDK-ja, në përputhje me Kushtetutën dhe në kuadër të mandatit që e ka pasur për ta kontestuar këtë ligj, nuk ka ndonjë pengesë kushtetuese për sa kohë kjo nuk është thënë as nga vetë Gjykata Kushtetuese.

Kryetari, tha se janë tre elemente esenciale të këtij projektligji, përkundër që janë kontestuar nga Grupi Parlamentar i PDK-së, në rastin konkret Gjykata Kushtetuese nuk ka gjetur mospërputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e të cilat në fakt e përbëjnë këtë politikë të re ligjore të adresimit të luftës kundër korrupsionit. Në radhë është koncepti i konfiskimit civil, në këtë gjë Gjykata Kushtetuese ka konstatuar që është në përputhje me Kushtetutën dhe i shërben interesit publik. Në radhë të dytë, është retroaktiviteti në kuptimin e adresimit të një plaje të vazhdueshme të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, që nga shpallja e pavarësisë. Natyrisht, që keqpërdorimi ka ndodhur edhe më parë, por që për arsye që tashmë janë dhënë e shpjegime që janë bërë, ka një lloj pikënisje në rastin konkret, rastin e konsolidimit të institucioneve dhe të sistemit tonë ligjor. Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se në raste të tilla, kur bëhet fjalë për procedurë civile dhe administrative, retroaktiviteti është i lejueshëm dhe është në përputhje me Kushtetutën, për sa kohë që është proporcional dhe i shërben përsëri interesit publik. E në rastin konkret, keqpërdorimi i fondeve dhe i pasurisë, natyrisht që adresimi i tyre i shërben interesit publik. Dhe e treta, që është esenciale, është barra e provës të pala, që përsëri përkundër kontestimit, Gjykata Kushtetuese në princip ka gjetur që është në përputhje me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese ka konstatuar katër elemente që i dalin jashtë thelbit, që nuk janë në përputhje me Kushtetutën. Në vijim, tha se është i bindur edhe nga leximet që i ka bërë projektligjit, që Ministria e Drejtësisë, me kujdesin maksimal, brenda mundësive që janë në dispozicion, e ka adresuar fushëveprimin, në kuptimin e qartësisë se çfarë nënkupton retroaktiviteti i verifikimit për pasurinë e pajustificueshme për zyrtarët e lartë publikë në dhjetë vitet e fundit, inicimin e procedurës deri në dhjetë vite nga lirimi ose largimi nga detyra dhe periudhën deri në pesë vite të pasurisë së fituar nga zyrtarët e lartë, edhe pas lirit nga detyra e zyrtarit të lartë publik.

Elementi i dytë, që e ka adresuar, padyshim janë garancitë procedurale, meqenëse bëhet fjalë që barra e provës i bie palës, Gjykata Kushtetuese, marrë parasysh ata shembuj, që ka ilustruar me disa ligje në Kosovë, që me disa ligje në Kosovë, të dhënat nuk ruhen më shumë sesa dhjetë vite, përkundër shpjegimeve që janë dhënë, nga se të dhënat ruhen. Megjithatë, po e marrim si të mirëqenë referencën. Adresimi i Ministrisë së Drejtësisë për pamundësinë objektive që në rastin konkret kur pala, meqenëse e ka barrën e provës, nuk mund të sigurojë dokumente, nuk ka dokumente në dispozicion, sepse institucionet përgjegjëse i kanë asgjësuar ato, atëherë Gjykata, pas lëshimit të urdhrin, nëse kjo është e mundur për t'u siguruar, përdoret si mekanizëm. Nëse as edhe pas këtij veprimi nuk është e mundur që sigurohet dokumentacioni, Gjykata pushon verifikimin ose procedurën për atë pjesë të pasurisë.

E treta është përbërja e Komisionit Mbikëqyrës. Në radhë të parë Komisioni Mbikëqyrës do të ketë autorizime të kufizuara në kuptimin e inicimit të rasteve për verifikimin e pasurisë së pajustificueshme, sepse këtë rol do ta ketë në veçanti drejtori. Por, që si një Komision, si një trup kolegjal do të ketë përgjegjësi hartimin e akteve nënligjore të përgjithshme dhe të mbikëqyrjes së punës së drejtorit si një trup i përhershëm. Kjo nuk e përjashton natyrisht Kuvendin, si institucion mbikëqyrës dhe Komisionin për Legjislacion gjithsesi.

Më tutje vazhdoi se, e vërteta është që synimin fisnik që e kemi pasur në projektligjin e parë, e kemi trajtuar me kujdes dhe kemi synuar që të krijojmë një mekanizëm ndërinstucionalë në emër të pavarësisë dhe të paanshmërisë. Një gjyqtar të Gjykatës Supreme që do ta kryesonte këtë Komision Mbikëqyrës. Auditorin e Përgjithshëm si një institucion i specializuar në fushën e kontrollit financiar dhe një zëvendës nga Avokati i Popullit, përveç Drejtorit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe të Inteligjencës Financiare. Gjykata Kushtetuese ka konstatuar që gjyqtarët nuk mund të ushtrojnë funksione tjera, Auditori i Përgjithshëm po ashtu, sikurse dhe zëvendësi i Avokatit të Popullit. Në një situatë të tillë, Kuvendit nuk i mbeten opsione tjera, përveçse për të u siguruar që funksionalizohet ky institucion i rëndësishëm dhe i domosdoshëm. Por, edhe garantohet kushtetutshmëria.

Ministrja u paraqit e hapur për opsione, ndërsa unë u shpreh se ka një qëndrim më strikt në këtë pikë, për shkak se politikisht këtu ka dy opsione, pa dashur që të ketë replika ose debate. Ndoshta me ata që do të duhej të kishte më shumë debat, nuk janë këtu. Ka dy pozicione në raport me verifikimin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme. Një pozicion është i sponsorizuesit të projektligjit, që pasuria e pajustificueshme e zyrtarit të lartë publik duhet të verifikohet, duhet të konfiskohet dhe duhet t'i kthehet shtetit. Vlerësimi është që përgjatë viteve në Kosovë është keqpërdorur detyra zyrtare, është keqpërdorur pozita për të shtuar pasurinë personale në mënyrë të paligjshme duke e zvogëluar pasurinë publike. Një pozicion tjetër politik, të cilët e kanë kontestuar projektligjin, është se pasuria e pajustificueshme nuk duhet të verifikohet dhe nuk duhet të konfiskohet. Në thelb, kjo nënkupton që duhet të ketë një lloj amnistie për pasurinë e pajustificueshme të zyrtarëve të lartë publikë, të cilën e kanë ngritur përgjatë viteve në Kosovë duke qenë në pozita publike. Sepse te kontestimi formal, me argumente kinse ligjore dhe kushtetuese është tjetër gjë dhe qëllimi dhe motivi politik është tjetër gjë. Natyrisht që i përkasim pozicionit që vlerësimi se në Kosovë se është keqpërdorur në mënyrë masive detyra zyrtare dhe pozicioni publik për të shtuar pasurinë personale në kurriz të pasurisë publike dhe interesit publik, duhet të adresohet dhe rruga më efikase për t'u adresuar është përmes mekanizmit të konfiskimit civil, duke u siguruar që respektohen liritë dhe të drejtat e njeriut, që të respektohet dhe që garantohet paanshmëria dhe që garantohet kushtetutshmëria edhe e ligjit por edhe e vetë institucionit. Po të kishte vullnet politik për ta adresuar këtë çështje në mënyrë gjithëpërfshirëse, nuk do të ishte vështirësi për t'i adresuar. Imagjinoni, edhe vetë kontestuesi i projektligjit paraparak, po të përfshihej në grupe të punës, po të paraqiste amendamente për këtë projektligj, ne sot nuk do të ishim duke e trajtuar për herë të dytë por do t'i adresonim që në herën e parë këto katër elemente të projektligjit dhe sot do të kishim ligjin në fuqi. Madje, për të u kthyer në atë që u tha, se po përdoret për arsye elektorale, nuk ka këtu ndërlidhje, është komplet veprimet e palëve tjera që e kanë determinuar kohën kur po e shqyrtojmë. 17 muaj bashkë me publikimin është mbajtur nga Gjykata Kushtetuese. Për arsye elektorale do të kishte pasur shumë dëshirë që ky projektligj të hynte në fuqi menjëherë kur është miratuar në 2022 dhe tani do e kishim Byronë për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme. Mbase do t'i kishim edhe rastet e para të verifikimit dhe konfiskimit të pasurisë. Por, janë të kufizuar. Gjykata Kushtetuese në këtë verë e ka nxjerrë Aktgjykimin, pastaj 30 ditë derisa e ka publikuar dhe me efikasitet ka vepruar Ministria

e Drejtësisë. Për fat të mirë, bëhet fjalë vetëm për katër nene. Për fat të keq, është shfuqizuar në tërësi ligji për shkak të vetëm katër neneve. Megjithatë, nuk sheh opsione tjera. Po të kishte vullnet, ne mund të hapnim diskutimin në kuptimin e opsioneve për përbërjen e Komisionit. Nuk ka këtu vullnet nga pala e cila e kundërshton në thelb konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, e ndërkohë që nuk po shohim opsione. A ka më shumë pavarësi sesa të ja lësh një gjyqtari të Gjykatës Supreme të kryesojë Komisionin? Nuk ka. Gjyqtarët nuk i zgjedh mazhoranca, nuk i zgjedh Kuvendi, kanë procedura tjera. Madje, në një kontekst çfarë jemi, dihet edhe çfarë mendimi kemi për sistemin ligjor. Megjithatë, në emër të pavarësisë, ja kemi deleguar. Është konstatuar që nuk është në përputhje me Kushtetutën. Prandaj, Kryetari mendon që duhet të ecin tutje kushdo që ka vërtetë vullnetin fisnik, pozitiv ta adresojë dhe ka ndonjë propozim se si mund të forcohen këto ndryshime dhe se si mund të garantojmë. Por, nuk është për të hapur kutinë e Pandorës për ndryshime të cilat e rrezikojnë edhe njëherë eventualisht kushtetutshmërinë e këtij projektligji, për shkak se kemi të bëjmë me një palë e cila është kundër konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme.

Kryetari vazhdoi se në lidhje me kërkesën e z. Selmanaj, për ta adresuar në Venecia, ministrja e dha qëndrimin e saj, dhe vetë do e thotë qëndrimin e tij. Natyrisht që i përket titullarit të institucionit, Kryetarit të Kuvendit, por mendon që nuk ka asnjë arsye. E para, ne kemi tri opinione të Venecias për këtë projektligj, pothuajse çdo gjë që është dashur të thuhet e ka mundur të thuhet për këtë projektligj është thënë nga Komisioni i Venecias. Aty i kemi rekomandimet, qoftë edhe për këto ndryshime, qoftë edhe për këto ndryshime që janë iniciuar. E dyta, e kemi Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese që ka vendosur një lloj kornize se çfarë duhet të bëhet dhe çfarë mund të bëhet. Dhe e treta, bëhet fjalë për katër nene, nuk bëhet fjalë për ligj të ri. Bëhet fjalë për katër nene të cilat as nuk janë thelbi i këtij instituti të ri të konfiskimit civil. Është Komisioni Mbikëqyrës, ka shumë institucione në Kosovë që kanë këtë rregullim ligjor për forcimin ose garancitë procedurale. Po ashtu, tha se nuk sheh asnjë arsye për ta dërguar në Venecia. Duke parë që e kemi diskutuar gjerë e gjerë këtë çështje, duke pasur parasysh nevojën dhe duke pasur parasysh se bëhet fjalë vetëm për disa ndryshime, Kryetari dëshiron që Kuvendi i Kosovës me prioritet ta trajtojë dhe ta miratojë dhe të hyj në fuqi dhe të filloj themelimi i Byrosë. Kur thotë me prioritet, nuk është duke thënë të mos respektohet rregullorja e Kuvendit dhe procedura. Por, bëhet fjalë për katër nene nuk ka hapësirë këtu as për shqyrtime të gjëra e të thella në mes të dy leximeve. Është shteruar materia.

Artan Abrashi, tha se është krijuar një praktikë e pazakontë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më konkretisht në këtë legjislaturë. Nëse ka ndodhur diçka e tillë edhe në legjislaturat tjera sikurse tash, është mirë të na thonë. Mirëpo, nuk ka qenë e zakonshme që Komisioni për Legjislacion apo Kuvendi i Republikës së Kosovës të jetë kaq i varur te Komisioni i Venecias sikurse në këtë legjislaturë. Vullneti i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka qenë dashamirës, në kuptimin që të marrim sa më shumë opinione profesionale, opinione të bazuara nga institucione tejet kredibile të Bashkimit Evropian, rreth çështjes së respektimit të të drejtave të njeriut, rreth çështjes së respektimit të Kushtetutës. Mirëpo, çfarë ka krijuar kjo praktikë është një diçka e pazakontë për shkak se kurrfarë obligimi nuk ka krijuar tek deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës opinioni i Venecias rreth çështjeve të cilat i kemi dërguar për shqyrtim. Nuk e ka ndryshuar qëndrimin e tyre politik, ndonëse argumente shumë të mjaftueshme ka ofruar, asgjë nuk ka provuar. Edhe çfarë është më e çuditshme është që nuk kanë krijuar asnjë fuqi obliguese ato opinione në Gjykatën Kushtetuese rreth çështjes së kushtetutshmërisë së projektligjeve që i kemi dërguar për shqyrtim. Prandaj, pyetja që shtrohet është kjo: se çfarë na duhet neve ky Komision kur realisht deri tash nuk ka ndikuar asgjë, por përkundrazi ka pasur karakter të zvarritjes së

projektligjeve që konsideron se janë jashtëzakonisht të rëndësishme, implementimi i të cilave është jashtëzakonisht i rëndësishëm për reformën tejet të nevojshme të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Është vullneti i mirë që ka qenë për të krijuar një projektligj që do ta siguronte pajtueshmërinë e të gjithëve dhe do të krijonte argumente të qëndrueshme rreth kushtetutshmërisë së iniciativave politike. Mirëpo, deri tani kjo nuk ka prodhuar asgjë. Prandaj, kur të përmendet Komisioni i Venecias, nuk e ka si replikë ndaj z. Selmanaj në përgjithësi sepse PDK-ja nuk e ka kundërshtuar themelimin e Byrosë, politikisht së paku. Por si të përmendet kjo në Kuvend, iniciativa për ta dërguar për shqyrtim në Komisionin e Venecias automatikisht përkthehet se ky projektligj duhet të zvarritet. Pra, më mirë është të thuhet a të e lëmë për më vonë. Shumë më e sinqertë është prej grupeve parlamentare të thuhet po e shtyjme, nuk është koha tani, po e shtyjme edhe pak për një periudhë më të përshtatshme. Prandaj, në përgjithësi, jo vetëm për çështjen e Byrosë. Ne nuk kemi kurrfarë obligimi as në aspektin e ligjor e as në aspektin procedural ndërvarësie nga ky Komision. E nisëm këtë punë, asgjë nuk po sjell rezultat. Së paku, këto janë të dhënat deri tani. Më nuk duhet të kemi punë me atë Komision, së paku deri të bëhemi pjesë e BE-së.

Dimal Basha, potencoi se PDK-ja nuk është aty. Kundërshtari më i madh i këtij projektligji siç duket ose ka një miratim të plotë ose nuk ka shpjegim mungesa e tyre, nuk kanë asnjë kundërshtim nga ana e tyre për një projektligj kaq të rëndësishëm. Problemi i dytë, qytetarët e Republikës tanimë janë në dijeni, arsyeja pse ky ligj nuk ka qëllime elektorale është për atë që u tha, që prej vitit 2021 është iniciativa, e në vitin 2022 ka gjetur miratimin, e 17 muaj rri në sirtarët e Gjykatës Kushtetuese. Është problem të bindet se nuk ka qenë politike edhe vonesa. Duhet të jepet një lloj shpjegimi, meqenëse edhe me ligj e kanë dy muaj. 17 muaj në sirtarë, asnjë lëvizje të vetme për një ligj që e kanë sulmuar në katër nene. Për më tepër, ne kemi praktika tjera që janë atakuar shumë më shumë nene dhe ligji ka mbetur në fuqi, ka thënë vetëm bëni ndryshimet në fjalë. Kjo nuk ka ndodhur me Ligjin për Byronë.

Po flasim tek pavarësia. Edhe gjithmonë askujt nuk po i bie mirë me njerëzit që po i zgjedhin. U tha te Kryetari i Gjykatës Supreme, që ne as nuk kemi të bëjmë me ta, nuk i zgjedhim. Është një institucion i pavarur që ka dhe problemet e tij dhe bindjet e tij që jo domosdoshmërisht shkojnë në atë të cilësisë së pavarësisë që duhet ta ketë ky institucion. Ne po e kemi problem, ne nuk kemi njerëz të pavarur. Në Amerikë, Ministri i Drejtësisë e përcakton një prokuror për ta hetuar një rast. Ata i kanë njerëzit e pavarur. Edhe ne jemi duke u munduar të krijojmë një sistem. Nuk bëjnë ata njerëz, pse të i zgjedh Kuvendi? Gjithmonë me paragjykimin që Kuvendi qenka i korruptuar. Për më tepër, Komisioni vetëm e bën mbikëqyrjen, Drejtori vetëm e bën punën dhe ka procedura që duhet të përcillen. Kur fillon, cila duhet të jetë baza ligjore për të filluar hetimin e një zyrtari publik? Edhe në Komisionin e Venecias, nuk e di një Ministri të Drejtësisë të mëparshme në historinë e Republikës që ka dërguar më shumë ligje se zonja Haxhiu. Ligjin e Byrosë tri herë e kemi pasur në Komisionin e Venecias dhe me të gjitha miratimet ose aprovimet e rekomandimeve që i kemi bërë në Kuvend, del Gjykata Kushtetuese që ka mendim ndryshe prej vetë Komisionit të Venecias, që është për t'u debatuar. Mund të diskutojmë, por ky ligj duhet të shkojë shpejtë për shkak se ka vonesa të shumta. Qytetarët e Republikës e presin, për shkak se ata janë duke punuar me djersë dhe nuk do askush përmes një pune me 1000 euro të bëhet milioner. Për shkak se ne e dimë që kjo është e pamundur. Dhe ne duam si Qeveri, ka qenë edhe zotim i yni që ata njerëz që e kanë fituar në barrë të shtetit, duhet të ja kthejnë barrës së shtetit dhe duhet të paguajnë dënimin për këtë dëm. Beson që këtu edhe Z. Selmanaj pajtohet. Prandaj, duhet të shtyhet përpara dhe pret përkrahjen e disa kolegëve, ndoshta jo të PDK-së, se ata do të dalin dhe do e dërgojnë në Gjykatë Kushtetuese papë vetëm për ta vonuar.

Vërejtjen e fundit te pavarësia, tha se ka qenë ithtar që ta kemi një Inspektor të Përgjithshëm ne. Ndoshta i raporton Kuvendit që ta kemi një njeri që e korrigjon brenda, për shkak se shteti është i përhershëm. Ne pas 50 vjetëve, nuk do jemi këtu, asnjëri prej nesh. Shteti shkon përtej nesh. Një Inspektor i Përgjithshëm kishte me qenë një mekanizëm shtesë për të bërë kontrollimin e Drejtorit dhe punës brenda. Ndoshta e diskutojmë.

Problemin e vetëm me projektligjin e ka tek dy anëtarët e rinj që janë, *ex officio*, Drejtori i Njësitit për Inteligjencën Financiare dhe i Agjencisë Kundër Korrupsionit. Problemi është se kuorumi i Komisionit Mbikëqyrës është katër, vendimmarrja është me tre. Tani nëse këta dy, për më tepër ne e kemi pakëz si praktikë që nganjëherë po mbesim me ushtrues detyre, e tani tre janë të Kuvendit të zgjedhur, por këtyre ju del afati në cilësinë e drejtorit. Këta e humbin edhe të drejtën për të qenë anëtarë të Komisionit, përfshirë edhe njëri prej tyre që mundet të jetë Kryetar. Atëherë, a duhet ne të bëjmë ushtruesin e detyrës të marr rolin derisa të zgjedhet Drejtori i ri në të dy rastet, meqenëse kjo e paralizon punën e Komisionit?

Driton Selmanaj, tha se nuk beson që i ka tradhtuar memoria për të thënë se kjo nuk ka qenë ide e Vetëvendosjes prej fillimi. Nuk e tha. Përkundrazi, e ka vlerësuar që nga fillimi idenë, edhe LDK-ja e ka pasur pjesë të programit të vetë politik por nuk ka arritur të fitojë zgjedhjet dhe ta bëjë vetë. Kur e tha për qëllime elektorale, e tha që është shpallur data e zgjedhjeve. I kemi edhe katër muaj zgjedhjet. Kuvendi është funksional deri në dhjetor. Por, të pretendohet të krijohen mekanizma të rinj për herë të parë në sistemin shtetëror të Kosovës në ditët e fundit të një mandati të një Qeverie, është shumë mos të themi pretencioze, por nuk ka dëgjuar së paku që dikush provon në fazat e fundit, ditët e fundit të mandatit të vetë të Qeverisë të krijojë mekanizma të tillë që janë për herë të parë në histori të shtetit të Kosovës. Sepse ne mund të nisemi me premisat që keni për të fituar zgjedhjet përsëri por, demokracia nuk i njeh këto forma sepse nuk e dimë kush i fiton zgjedhjet, nuk e dimë a i pëlqen kjo politikë apo jo. Kjo ishte arsyeja, duke u nisur prej një argumenti, pse e tha që është për qëllime elektorale. Jo se ju keni pritur deri në fund dhe tani e keni dorëzuar. Përkundrazi, nuk ka asnjë intencë të tillë.

Më tutje tha, se nuk ka parë dhe nuk ka dëgjuar zyrtarisht se në Kuvend të Kosovës që dikush prej partive politike është kundër idesë së konfiskimit të pasurisë së pajustificueshme në Kosovë, konfiskimit civil të pasurimit pabazë. Vetë ka kontestuar formën e këtij projektligji, prandaj nuk është përfshirë në grupe punuese fare. Dhe koha, sipas tij, i ka dhënë të drejtë pse nuk është përfshirë. Edhe për Ligjin për Këshillin Prokurorial edhe për këtë. Nuk ju ka dhënë të drejtë juve. Nuk ka mundur të përfshihet diku, të bëhet noterizues i punëve që, për mendimin e tij, nuk janë profesionale. Absolutisht nuk do të lidhet me qëllime politike. Dhe në disa raste kur është përfshirë në grupe punuese, e ka parë që amendamentet tua ose mendimet tua janë të kota kur qëllimi politik është i madh. E pse të shkojë diku e të bëhet noterizues, nuk e luan atë rol asnjëherë. Por, koha e ka dëshmuar që edhe për KPK-në edhe për këtë keni gabuar ju. Leximi i Komisionit të Venecias është gabim. Po i lexojmë dokumentet e njejtja, po i lexoni gabim. Kur po na e sjellin në fund dokumentin po del që nuk e keni reflektuar atë çfarë e keni kërkuar. Komisioni i Venecias mendon që është praktika më e mirë në parlamentarizmin e Kosovës që kanë filluar të i referohen atij. Vendet që aspirojnë të hyjnë në proceset e integritetit të Bashkimit Evropian, e shfrytëzojnë edhe më shpesh se ne sepse opinionet me të vërtetë janë opinione, si të tilla nuk janë detyruese. Bëhen detyruese kur ti fillon procesin e integritetit për të ecur tutje. Opinione të Komisionit të Venecias përmenden edhe në procese për anëtarësim në Këshill të Evropës. Sado që duken, janë të thjeshta, janë opinione. Por, janë opinione që përcaktojnë standarde. Dhe kur përcaktojnë standarde janë

kushte politike nesër. Prandaj, tek ne nuk ka pasur nevojë të ndryshojë qëndrim Komisioni i Venecias. Ka thënë që të respektohet Komisioni i Venecias dhe është i bindur që nuk është respektuar prandaj Gjykata Kushtetuese ka ardhur në përfundim.

Reduktimi për të thënë janë katër nene, mos harroni se me një nen mund të prishet sistemi. Vetëm më një nen të vetëm. Pavarësia e këtij institucioni është kruciale sepse me bindje e thotë, ky institucion ka mundësi të jashtëzakonshme për të u shfrytëzuar në mjet të persekutimit politik të kundërshtarëve. Nuk po thotë prej jush, po prej tjerëve që në të kaluarën e ka parë që shumë lehtë i shfrytëzojnë mekanizmat e vetë shtetërorë për të abuzuar dhe për të ju lëshuar në qafë kundërshtarëve. E kemi përjetuar. Edhe ju në shumë situata tjera përpara. Prandaj, mendon se nuk guxojmë ta kalojmë me shumë lehtësi pavarësinë. Është shumë me rëndësi. Sot, shefin e Njësitit për Inteligjencën Financiare e zgjedh Qeveria. Sot, Drejtorin e Agjencisë e keni zgjedhur ju, i zgjidhni dhe këta të tre ju. Por nesër, një shumicë tjetër politike. Është në dorë të politikës një instrument, një institucion që nuk e keni idenë se çfarë persekutimi mund t'i bëhet kundërshtarëve. Në këtë kontekst ka folur dhe në këtë kontekst po flet. Është pro idesë dhe politikës së tillë për të konfiskuar pasurimin e pabazë. Ka thënë që duhet të kthehet prej procesit të privatizimit. Aty janë bërë bazat e pasurimit të pabazë masiv, kur ka fillua procesi i privatizimit prej AKP-së, prej AKM-së në atë kohë. Jo në 2008, por po fillojmë prej 2000. Por, duhet të gjejmë mënyrën si sepse ecim në një teh prej qëllimit fisnik dhe persekutimit të kundërshtarit. E thekson përsëri se nuk e ka aludimin tek një parti politike, e ka aludimin tek siguria e jetesës në këtë vend. Prandaj, Komisioni i Venecias mendon se i ndihmon shumë këtij vendi nëse i validon dhe thotë se ju keni reflektuar. Sepse nuk merr më kohë shumë. Ata e kanë trajtuar disa herë këtë temë dhe çështjet që i kanë trajtuar nuk trajtohen edhe njëherë. Gjykata Kushtetuese ka dalë konform tyre. Sipas bindjeve të tij, prej fillimit ka thënë që është gabim dhe ka dalë gabim, andaj mendon se Komisioni i Venecias e validon politikën e juaj ose e kundërshton politikën e juaj dhe na ndihmon neve ta përmirësojmë. Ky është sugjerimi i tij, mund të vendosin si të duan, por mendon se duhet të jeni të kujdesshëm sepse është një ndër institucionet më të rëndësishme pas pavarësisë së Kosovës.

Albulena Haxhiu, mendon se nuk duhet të nisim prej premisë që po ndërtojmë institucione ose mekanizma të rinj të cilët janë hakmarrës. Mendon se është gabim. Dhe nëse nisemi prej kësaj logjike, secili institucion sot mund ta keqpërdorë detyrën, si rëndom e kanë bërë. Dihet rastet kur vetëm sepse kanë pasur të drejtë të ngritin aktakuzën, e kanë bërë të njëjtën. Por, fati i mirë është që këto vendime të institucioneve kanë shkallë të parë, e kanë shkallë të dytë e kanë verifikim. Në këtë rast, kur është themeluar ky institucion, gjegjësisht kur kemi nisur përpjekjet për ta themeluar këtë mekanizëm kanë thënë që do të krijojmë një institucion që do të konfiskojë pasuritë e pajustificueshme. Ju e dini shumë mirë që kjo nuk është kështu. Ne po ndërtojmë një institucion i cili do ta bëjë verifikimin e pasurisë së zyrtarëve dhe në momentin kur konsiderohet se ajo është e pajustificueshme, kërkon nga Gjykata konfiskimin e saj. Pra, prapë vendimin për të njëjtën e merr Gjykata dhe jo institucioni, pra Byroja. Prandaj, në këtë drejtim, nuk do ishte dashur të kundërshtohet ideja e ngritjes së këtij institucioni me arsyetimin se do të shërbejë pak a shumë si mashë ndaj kundërshtarëve politik. Për Republikën e Kosovës si një vend demokratik, është gabim që të ketë zyrtarë apo institucione të cilët veprojnë në këtë drejtim. Por, ne e kemi parë, po shohim edhe sot se vetëm për shkak të politikave të Qeverisë ka përpjekje apo hakmarrje ndaj Qeverisë nga ana e institucioneve. Prandaj, nuk ishte dashur që konceptin e konfiskimit civil të e kundërshtoni në emër të kësaj.

Më tutje, fton që ta lexojnë opinionin e Venecias të 14 marsit të vitit 2023, që është publikuar edhe

në ueb faqen e tyre. Se Komisioni i Venecias e ka validuar këtë ligj evidentohet në këtë opinion. Fatkeqësisht, është ajo çfarë z. Abrashi po e thekson, ndonëse në një mënyrë pak më brutale, por për shkak të rrethanave në të cilat ka kaluar e kupton qasjen që e ka ngritur sepse Gjykata Kushtetuese konsultohet me Komisionin e Venecias në vazhdimësi. Edhe në të kaluarën kështu ka ndodhur. Nëse i shihni aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, në të shumtën e rasteve apo pothuajse të gjitha, i referohet opinioneve të Komisionit të Venecias apo praktikave të vendeve tjera. Dhe ka qenë e papranueshme se si ka mundësi që ne marrim dritën e gjelbër nga Venecia dhe në anën tjetër kundërshtohemi nga Gjykata Kushtetuese për çështje që na ka dhënë të drejtë Komisioni i Venecias. Një rast më të thjeshtin, sepse për Byronë ka shumë çështje, i gjeni në këtë. Shefi i Kabinetit me vetëm një fjali thotë se seria e ndryshimeve, amendamenteve që i kemi dërguar, adresoi rekomandimet e bëra nga Komisioni i Venecias në opinionin përcjellës, të 14 marsit të vitit 2023.

Që nga Ligji për Këshillin Prokurorial, Komisioni i Venecias ka thënë se keni të drejtë që anëtarëve të Këshillit Prokurorial të i ndërprisni mandatin për hir të jetësimit të reformës. Sepse ka konsideruar se reforma në drejtësi është shumë më e madhe se interesi individual i anëtarëve. Por, ka thënë që megjithatë mos ua ndërprisni të gjithëve, por leni të paktën disa me short, që i binte tre anëtarë me short, Kryeprokurori dhe tre anëtarë jo prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi. Gjykata Kushtetuese ka thënë jo sepse kjo e cenon sigurinë juridike. Gjykata Kushtetuese nuk ka lënë që me ligj t'i ndërprisim mandatet e Këshillit Prokurorial, sepse janë të rregulluara me ligj dhe jo me Kushtetutë, ka thënë se e cenon sigurinë juridike. Por, këtë e ka trajtuar Venecia dhe Venecia ka thënë që interesi i përgjithshëm është më i rëndësishëm se ai individual. Prandaj, është vetëm një rast i thjeshtë për të dëshmuar që Gjykata Kushtetuese nuk po i adreson siç duhet vetë opinionet e Komisionit të Venecias. Dhe çfarë ka qenë e pa parë ndonjëherë, e paprecedent, është që pikërisht për Ligjin për Byronë, Komisioni i Venecias në mars e ka publikuar këtë dokument pa e kërkuar askush. Ne nuk ja kemi kërkuar, Gjykata Kushtetuese nuk beson fare. E ka publikuar pa pasur ndonjë rrethanë që e ka detyruar që ta bëjë këtë. Vetëm e ka publikuar që ka konsideruar që i kemi adresuar të gjitha rekomandimet e tyre.

Çështja tjetër është që, edhe njëherë po i rikthehemi se nuk e kemi për qëllime elektorale. Këtë nuk e beson askush sepse ka përpjekje të disa viteve që janë duke tentuar që ta bëjnë këtë. Po, në Kosovë ka subjekte politike që e kundërshtojnë konfiskimin civil. Këtë e ka bërë PDK-ja dhe është keq që sot nuk janë të pranishëm, sepse është dashur që të ballafaqohemi me argumentet apo ndoshta për shkak se shumë prej çështjeve që ata i kanë ngritur, duke nisur prej konfiskimit civil që e kanë kundërshtuar si të tillë dhe shumë çështje tjera, Gjykata Kushtetuese ka thënë që nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën. Ndoshta, kjo është arsyeja se pse nuk janë këtu për t'i sqaruar një nga një të gjitha çështjet që i kanë ngritur. Por çfarë ka qenë një gjë po aq e rëndësishme është që PDK-ja ka thënë se nëse e ka kontestuar konceptin e konfiskimit civil, por ka thënë që nëse kjo bëhet të vlejë për të gjithë qytetarët. Por jo, Gjykata Kushtetuese ka thënë jo. Ka ligje që bëhen për vetëm një kategori të zyrtarëve, në këtë rast për zyrtarët e shtetit, sepse qëllimi është që të ndiqen ata të cilët në emër të detyrës zyrtare kanë krijuar pasuri të pajustificueshme. Dhe e ka validuar, e ka konsideruar se kjo është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ministrja fton që të votohet sot në parim. Thekson se ka një qëndrim pak më ndryshe se Kryetari i Komisionit, vlerëson se nëse ka hapësira, ndonëse është diskutuar shumë për Komisionin Mbikëqyrës, nëse dikujt i kujtohet ndonjë ide tjetër le ta propozojë atë. Ka qenë opozitë, shumë amendamente kanë propozuar, shumë pak ju kanë kaluar. Mirëpo, kjo nuk i ka ndalur në të drejtën që të dërgojnë amendamente në projektligje të ndryshme. Të gjitha ato i keni, sepse janë në arkivin e Komisionit për Legjislacion. Nuk është e barrikaduar për ndonjë ndryshim që nuk bie ndesh me

Kushtetutën, duke pasur parasysh përpjekjet e një grupi opozitar që sërish ta kontestojë këtë ligj me qëllim të zvarritjes në Gjykatën Kushtetuese.

Driton Selmanaj, tha se do të votonte pro miratimit në parim me një kusht që t'i rekomandohet seancës për ta referuar në Komisionin e Venecias.

Kryetari, tha se u diskutua për këtë çështje që nuk i përket Komisionit, por e as nuk e ndalon Komisioni.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me 6 vota për vendosi, që Kuvendit t'ia paraqes këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr.08/L-322 për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme

1. Miratimi i draft planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024

Kryetari, propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me këtë propozim.

2. Raport me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat

Kryetari, tha se ka qenë kryesues i grupit të punë i caktuar nga Komisioni për Legjislacion. Grupi punës e ka trajtuar projektligjin mes dy leximeve dhe kemi sjellë raportin me amendamente i cili përmban 35 amendamente.

Kryetari konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota për dhe një kundër miratoi raportin me amendamente dhe vendosi që, Kuvendit dhe komisioneve kryesore t'ua paraqesë këtë:

R a p o r t

Për Projektligjin nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat nr.05

3. Raport me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-283 për harmonizimin e Ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L- 087 për kundërvajtje

Kryetari, tha se po ashtu, edhe këtu ka qenë kryesues i grupit të punës. Grupi i punës e ka trajtuar projektligjin mes dy leximeve dhe raporti me amendamente përmban gjithsej 34 amendamente. Ky është një ligj që synon të harmonizohen ligjet e veçanta me Ligjin për Kundërvajtje. Është një projektligj i formës omnibus. Që të dihet për opinionin, Kryetari theksoi se zoti Selmanaj është kundër në metodologji dhe jo në përmbajtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni, me gjashtë vota për dhe një kundër miratoi raportin me amendamente dhe vendosi që, Kuvendit dhe komisioneve kryesore t'ua paraqesë këtë:

R a p o r t

Për Projektligjin nr. 08/L-283 për harmonizimin e Ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje.

4. Të ndryshme

Në këtë pikë nuk pati më çështje për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Adnan Rrustemi,
Kryetar i Komisionit
